



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 675/3 prot.

Tiranë, më 05.07.2023

### V E N D I M

**Nr. 119, datë 05.07.2023**

Mbështetur në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 103 Regj., datë 31.05.2023, të P. S., në cilësinë e prindit të fëmijës G. S., kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit<sup>1</sup> dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Malësi e Madhe<sup>2</sup>, me pretendimin diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar të djalit të tij.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të paraqitur në ankesë, P. S. ka parashtruar ndër të tjera se djali i tij, G. S., është i regjistruar në Shkollën 9-vjeçare “Kol Maçi”, në Rapsh, Hot, Malësi e Madhe. Ai vuan nga çrregullime të spektrit autik dhe për këtë arsye ka nevojë të asistohet nga mësues ndihmës. Në cilësinë e prindit, i është drejtuar disa herë institucioneve arsimore me kërkesë dhe është informuar se djalit të tij i është caktuar mësuesi ndihmës, por konkretisht sipas tij, mësuesi nuk është paraqitur asnjëherë në shkollë. Sakaq, ankuesi thekson se i është drejtuar sërish institucioneve arsimore përgjegjëse por nuk ka marrë më përgjigje.

Në vijim, sqaron se është vënë në dijeni nga ana e ZVAP Malësi e Madhe se për djalin e tij është emëruar një mësues ndihmës, por që nuk ka pranuar ushtrorë këtë detyrë. Gjithashtu, sipas P. S., në shkollën ku ndjek mësimin djali i tij, është edhe një fëmijë tjetër të cilit i është caktuar mësuesi ndihmës. Në këtë kuptim, ankuesi pretendon se djali i tij, G. S., është vënë në pozita diskriminuese nga ana e MAS dhe ZVAP Malësi e Madhe, për shkak të aftësisë së kufizuar, si rezultat i faktit që nuk i është caktuar mësues ndihmës.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin MAS.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin ZVAP Malësi e Madhe.

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të djalit të tij, G. S., nga ana e MAS dhe ZVAP Malësi e Madhe, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe caktimin e një mësuesi ndihmës për të në vitin shkollor 2023-2024.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7/1 i LMD-së<sup>3</sup>, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”*.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 103, datë 31.05.2023, të bërë nga P. S., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 657/1 prot., datë 09.06.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, MAS dhe ZVAP Malësi e Madhe, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesën e bërë nga P. S.

Në përgjigje përsa më sipërcituar, MAS me shkresën<sup>4</sup> Nr. 3688/3 prot., datë 22.06.2023 dhe ZVAP Malësi e Madhe me shkresën<sup>5</sup> nr. 238 prot., datë 15.06.2023, informuan Komisionerin ndër të tjera se: *“...janë marrë të gjitha masat për vlerësimin e nevojave të të nxëniet dhe emërimin e një mësuesi ndihmës për nxënësin G. S., por duke mbajtur në konsideratë që diagnostikimi i nxënësit është bërë gjatë vitit shkollor dhe procedura për përzgjedhjen e një mësuesi ndihmës ka nisur në gjysmë të vitit shkollor dhe nuk ka pasur asnjë pranim nga kandidatët në portal...për vitin shkollor 2023-2024, ka filluar marrjen dhe do të angazhohet*

<sup>3</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

<sup>4</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 675/2 prot., datë 23.06.2023

<sup>5</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 675/1 prot., datë 19.06.2023

*maksimalisht që nxënësit G. S. t'i ofrohet një mësues ndihmës dhe i specializuar, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021, i ndryshuar, në funksion të përmbushjes së qëllimit kryesor të këtij institucioni që është arsimimi dhe ofrimi i një trajtimi të specializuar për nxënësit e kësaj kategorie...”.*

2. Referuar informacionit të sipërcituar, Komisioneri me anë të e-mail-it datë 26.06.2023, vuri në dispozicion të ankuesit kopje të shkresave të MAS dhe ZVAP Malësi e Madhe.

Në përgjigje përsa më lart, ankuesi me anë të e-mail-it datë 03.07.2023, kërkoi nga Komisioneri mbylljen e ankesës duke qenë se problemi i parashtruar në të mori zgjidhje.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga P. S., i cili me anë të kërkesës së paraqitur me e-mail-in datë 03.07.2023 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 103, datë 31.05.2023, të paraqitur nga P. S., kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Zyres Vendore të Arsimit Parauniversitar Malësi e Madhe, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Rekomandohet Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Malësi e Madhe, në fillim të vitit shkollor 2023-2024, të njoftojnë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me masat e marra në ofrimin e mësuesit ndihmës për nxënësin G. S.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Aftësi e kufizuar)

(Fusha: Arsim)